

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**PASAREL FASHION SHPK**

Sot me datën 05/09/2024 (dymijë e njëzet e katër), unë Ortaku themelues :

*Alba Gjoci, shtetase shqiptare, atesia Gezim, e datëlindjes 03 Korrik 1989, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me kartë identiteti me ID 033145461 dhe Nr.personal 195703082U*

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007” Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ”,

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “PASAREL FASHION” SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë emër tregtar “ PASAREL FASHION” SHPK

**NENI 2**

**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në adresën:

Durrës, Rruga Vllazërimi, Zona Kadastrale 8513, Godinë me Nr.pasurie 12/117+1-1

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj si vijon :

Tregtim, Import-eksport, prodhimin, përpunimin, transformimin dhe ambalazhimin e konfeksioneve, rrobave të gatshme, veshmbathje tekstile, të pambukta dhe të lehta të të gjitha llojeve, lendeve të para për industrinë e konfeksioneve., etj.

Aktivitet sipas regjimit të përpunimit aktiv( Fason).

Konsulencë, asistencë, dhe çfarëdo operacioni tjetër tregtar i lidhur me zhvillimin e aktivitetit të konfeksioneve.



Tregtim te artikujve te ndryshme industriale, lendeve te para, makineri e pjese kembime per makineri te ndryshme, etj

Marrjen e perfaqesimit te Kompanive te tjera qe operojne ne kete sektor.

Logjistike ndermarrjeje.

Shitje on-line te produkteve e veshmbathjeve te ndryshme.

Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete, per te trete e me qira.

Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj.

#### **NENI 4** **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (nje) kuote me vlerë nominale të një kuote prej 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**ALBA GJOCI** zotëron 1 (një) kuotë me 100% pjesemarrje në kapitalin e Shoqërisë me vlerë nominale prej 100,000 lekë.

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **IZET GJOCI**, i dl.18/04/1987, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, me Nr.personal I70418019T, i cili emërohet për një perludhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



**NENI 7**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**  
**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.  
Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**

**ALBA GJOCI**

Alba Gjoci  
